



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR PROJEKT-BUXHETIN E VITIT 2025 PËR LAGJEN
ADMINISTRATIVE BATHORE**

I mbajtur më 17.10.2024, në orën 16:30 , në dëgjesën me banorët e Lagjes Administrative Bathore, në lidhje me projekt-buxhetin e vitit 2025.

Takimi u zhvillua në Pedonalen e Bathores.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë së Kamëz, Z. Rakip Suli;
- Deputetja e zonës , Znj. Lindita Nikolli;
- Administratori i Lagjes Administrative Bathore, Z.Afrim Doçi;
- Kryetari i Këshillit Bashkiak Kamëz, Z.Hysen Koldashi;
- Anëtarët e Këshillit Bashkiak Kamëz;
- Ndërlidhësit me komunitetin;
- Qytetarët e zonës.

Takimin e hapi administratori i Lagjes Administrative Bathore, z. Afrim Doçi, i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit, deputeten e zonës, znj.Lindita Nikolli, kryetarin e Bashkisë Kamëz, z.Rakip Suli, si dhe strukturat bashkiake për punën dhe investimet e kryera.

Më pas fjala i kaloi deputetes së zonës, znj.Lindita Nikolli, e cila falënderoi pjesëmarrësit dhe kryetarin Rakip Suli për investimet e bëra në Bashkinë Kamëz përgjatë 5 viteve.“ Faleminderit Rakip për shembullin që na jep, faleminderit për punët e mira që ke bërë në Kamëz. Është rasti për t’u ndjerë krenarë se si besimi i shprehur me votë, ndaj një njeriu si kryetari Rakip Suli përkthehet në më shumë punë, në më shumë përkujdesje, në më shumë shërbime, në më shumë investime, ide dhe projekte për Bashkinë Kamëz. Ju i keni ndjerë fare mirë transformimet që janë bërë në

Bashkinë Kamëz, edhe këtu në Bathore është një pedonale që flet vetë, janë shkollat, kopshtet, çerdhet, rrugët që janë ndërtuar dhe asfaltuar flasin vetë. Mbi të gjitha, që është më e qenësishmja në këndvështrimin tim është marrëdhënia me qytetarët e Kamzës, respekti dhe llogaridhënia. Llogaridhënia dhe transparenca për çdo investim, për çdo lek nga taksapaguesit shqiptarë që kalon në buxhetin e Bashkisë Kamëz. Një gjë është e qartë, se investimet që Rakip Suli ka bërë në Bashkinë Kamëz në këto 5 vite janë më shumë se të gjitha investimet e bëra në 30 vite në Bashkinë Kamëz”, u shpreh Nikolli.

Më pas fjalën e mori kryetari i Bashkisë Kamëz, z.Rakip Suli, i cili pasi falënderoi pjesëmarrësit dhe deputeten e zonës, znj. Lindita Nikolli, vuri theksin tek rëndësia e dëgjësive publike. “ Ne jemi një familje e madhe që i diskutojmë gjërat dhe i marrim vendimet e përbashkëta me transparençë, që është jo vetëm themeli i demokracisë, por dhe i moralit të politikës. Nëse para 4 viteve do t’ju thoja që këtë kanal in këtu do ta kthej në Pedonale askush nuk do ta besonte”, u shpreh z.Suli.

Më pas kryetari Rakip Suli bëri një përmbledhje të të gjitha punëve të bëra në Bashkinë Kamëz, në arsim, infrastrukturë, ujësjellës, kanalizime si dhe në politikat sociale. Investimet e bëra jo vetëm kanë përmirësuar jetesën e banorëve, por kanë rritur dhe vlerën e pronës, duke ndryshuar kështu dhe perceptimin për Kamzën në përgjithësi.

Punët e bëra në këto 5-vite

➤ Investimet 2019-2024, Bashkia Kamëz

- 40 objekte arsimore, nga të cilat 8 objekte arsimore në Lagjen Administrative Bathore, 3 shkolla , 5 kopshte dhe çerdhe.
- Infrastrukturë rrugore 195 km, nga të cilat në Lagjen Bathore janë investuar 46.8 km, rreth 144 rrugë.
- Ujësjellës 195 km, ku Lagjja Bathore është 100% e mbuluar me ujë të pijshëm.
- Kanalizime 125 km, nga të cilat në Lagjen Bathore janë investuar rreth 20km kanalizime.

- Ndërtimi i Parkut të Paskuqanit
- Ndërtimi i Pedonales së Bathores
- Vitin e parë në Paskuqan përfunduar urën;
- 54 pallate të rehabilituar
- Ambjente sportive
- Rindërtimi nga tërmeti : 426 banesa individuale
- Pallate Valias: 19/270 apartamente
- Ambiente sportive
- Krijimi i stacionit zjarrfikës në Valias.
- Blerja e makinave të pastrimit të qytetit.

➤ ***Të Rinjtë***

- 630 bursa ekselence.
- 162 ekipe sportive / 1550 të rinj.
- Panairi i Librit “Kamza Lexon”.
- Klubi i Librit.
- Konkurse artistike për të rinjtë.
- Këshilli Rinor.
- Praktika pune.
- Kurse profesionale.
- Karta e studentit

➤ ***Taksa dhe Tarifa vendore***

- Tarifa 0 për çdo biznes të ri (për 1 vit), nga 28.000 lek/Viti në 0 lek/Viti
Viti 2021-2024 (1519 subjekte përfituese).
- Ulja e tarifave dhe taksave me 60 %
Viti 2022-2024 (3978 subjekte përfituese).

Kategoritë	2019	2024
Pensionistët	6000	1200
Invalidët e punës, të verberit, paraplegjik dhe tetraplegjik	6000	1800
Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike	6000	0
Familjet që trajtohen nga PAK	6000	2000
Kryefamiljare femra me më shumë se një fëmijë	6000	1800

- Numri i përfituesve nga ulja e taksave familjare për vitin 2023

Përfitues 2023	
Ndihme ekonomike	528
Invalid	1453
Pensionist	2225

➤ **Politikat Sociale**

- Taksa 0 për familjet në nevojë .
- Kopshte/çerdhe pa pagesë, 500 fëmijë.
- Qendra Multifunksionale, 99 fëmijë.
- Familje me bonus qiraje nga strehimi social 752.
- Kredi të buta 74 familje
- Rehabilitimi i banesave.
- Punësimi i personave me aftësi ndryshe.

Kryetari i Bashkisë z.Rakip Suli, u ndal edhe tek investimet që do të bëhen në Lagjen Administrative Bathore gjatë vitit 2025.

Investimet e parashikuar në projekt-buxhetin e vitit 2025 për Lagjen Administrative Bathore.

- Infrastrukturë rrugore 20,33 km, 89 rrugë
 - Në Lagjen nr.1 do të investohet në 3 rrugë
 - Në Lagjen nr.2 do të investohet në 9 rrugë
 - Në Lagjen nr.3 do të investohet në 4 rrugë
 - Në Lagjen nr.4 do të investohet në 17 rrugë
 - Në Lagjen nr.5 do të investohet në 37 rrugë
 - Në Lagjen nr.6 do të investohet në 7 rrugë
 - Në Lagjen nr.7 do të investohet në 12 rrugë

Secilit pjesëmarrës në takim iu dha mundësia dhe koha për t'u përfshirë në diskutimin e ngritur me kërkesa, sugjerime dhe pyetje, se çfarë mund të ofrojë Bashkia Kamëz për mbështetjen dhe zgjidhjen e problemeve.

Diskutime:

Banori Ramadan Allai,

Mirë se erdhe në Bathore Kryetar. Unë kam shumë respekt për ju z.Kryetar, sepse erdhe dhe na premtove rrugën dhe e mbajte premtimin madje me ndërtove dhe avllinë.

Kryetari z.Rakip Suli,

Faleminderit, më vjen mirë që vlerësoni punën. Jemi angazhuar maksimalisht në ndërtimin e infrastrukturës rrugore, me cilësinë dhe standardet më të mira. Vlen te theksohet, se jemi ndër të parat dhe e vetmja bashki që jo vetëm ndërtojmë infrastrukturë rrugore, por dhe jemi pranë qytetarëve në ndërtimin e avllive, te cilat preken nga ndërtimi i rrugëve, pa asnjë kosto.

Banori Mirela Cala,

Përshëndetje jam Mirela Cala, jam një prind që kam fëmijët në çerdhe dhe kopshte, dua të

falënderoj për zemërsisht kryetarin e Bashkisë z.Rakip Suli, për gjithçka që keni bërë për zonën tonë, për shkollat, çerdhet, terrenet sportive si dhe për parqet e lojërave që të argëtohen fëmijët tanë, të ndërtuara me standardet më të mira.

Kryetari, z.Rakip Suli,

Ndjehem vërtet i lumtur kur shoh prindër që janë të kënaqur me kushtet në shkolla, kopshte dhe çerdhe, ku dërgojnë fëmijët e tyre. E kam thënë dhe më përpara se edhe po t'i mbledhim 61 bashkitë e vendit nuk kanë investuar në arsim aq sa ka investuar Rakip Suli në 4 vite. Kemi investuar në 40 objekte arsimore. Kur erdha në krye të Bashkisë Kamëz prindërit nuk kishin një çerdhe ku t'i çonin fëmijët e tyre, ndërsa sot kemi plot 6 çerdhe. I kemi gjetur shkollat jashtë çdo standardi, por sot Bashkia Kamëz ka bërë revolucion në infrastrukturën arsimore.

Banori Nazmi Çuni,

Përhëndetje të gjithëve. Unë kam qenë personi i parë që të kam takuar në zyrë kur erdhe në 2019-ën, sepse ai kryetari i parë nuk priste njëri në zyrë. Shpreha shqetësimin tim për ujin e pijshëm. Nuk ma mori mendja që do bëni ndonjë gjë. Dhe jam po unë që sot kam ujë të pijshëm në shtëpi fal premtimit që Kryetari mbajti. Edhe rrugët e lagjeve i ke bërë me të gjitha standardet me asfaltim, trotuare, ndriçim etj. Suksese Kryetar, zoti të dhëntë jetë.

Kryetari z.Rakip Suli,

Faleminderit për fjalët, por kemi akoma punë për të bërë. Janë investuar 195 km ujësjellës në të gjithë territorin e Bashkisë Kamëz. Lagjja Bathore është 100% e mbuluar me ujë të pijshëm. Për herë të parë në Kamëz janë vendosur semafor. Besoj që i keni parë semaforët e vendosur në disa kryqëzime kryesore, dhe te shkolla "Halit Coka" ku kalojnë fëmijët është vendosur semafor. Dhe patjetër se në projekt-buxhet janë parashikuar shumë rrugë të tjera që do të ndërtohen me të gjitha standardet.

Banori Fran Paluca,

Zoti kryetar, ju falënderoj për mundësinë e fjalës. Në radhë të parë dua të të falënderoj për

punën që keni bërë dhe në veçanti për Ndërmarrjen e Pastrim-Gjelbërimit, sepse shikohet ndryshimi në pastërtinë e të gjithë territorit të Bashkisë Kamëz. Si qytetar i zonës së Bathores mendoj se, në Bathore duhet një godinë për Njësinë Bathore në pronësinë e Bashkisë, sepse nuk duam që taksat e banorëve të shkojnë për qiranë e godinave. E dyta, meqenëse Liqeni i Paskuqanit po merr zhvillim ka disa rrugë në Bathore siç është rruga “Besëlidhja” që kufizohet nga rruga “Albavia”, si dhe Loti i rrugës “Azem Hajdari” me rrugën “2 Prill” që janë 2 arteriet që të çojnë te Liqeni i Paskuqanit, janë rrugë të ndërtuara shumë herët dhe kanë nevojë për investim. Ju faleminderit!

Kryetari z.Rakip Suli,

Faleminderit për pyetjen, e bukura e demokracisë është kur diskutojmë, japim mendime, shkëmbejmë ide dhe kur merren për bazë mendimet dhe shqetësimet e banorëve merren dhe vendimet e duhura. Është shumë i vërtetë shqetësimi i zotërisë, sepse po flasim për dy arteriet kryesore ku janë të planifikuara rreth 10 km rrugë asfaltim si dhe trotuare për rrugët që nuk kanë. Ndërsa për sa i përket zyrës së Njësisë është problemi i pronës. Kush nga ju e shet me 35 dollar metrin që të vij dhe ta blejë Bashkia Kamëz sepse me ligj aq është referenca. Është shumë e vërtetë që duhet një godinë simbolike dhe me parkim për Bathoren. Megjithatë, jemi Bashkia që kemi më pak ambiente me qira dhe që paguajmë një shumë simbolike për ambientet që kemi me qira.

Banori Elez Fishti,

Përsëendetje, jam Elez Fishti banor i Bathores. Ky popull ka qenë këtu që 30 vite dhe këtu është dhe sot. Populli ka nevojë për drejtues, ne e mbajmë mend këtë kanalin këtu që tani është Pedonale, mbajmë mend dhe ato rrugët e prishura, po ashtu dhe shkollat me 3 turne sa u detyruam t'i çonim fëmijët nëpër shkolla në Tiranë. Sot, ju bëj thirrje prindërve t'i sjellin fëmijët të shkollohen në Bathore, se ka shkollat më të mira në Shqipëri. Unë nuk jam as i majtë e as i djathtë, unë jam me atë që punon për këtë popull. Faleminderit kryetar që i ndryshove faqen Bathores. Ju bëj thirrje emigrantëve që të kthehen të shohin, si ka ndryshuar ky vend. Ne s'të lëmë të ikësh Kryetar, sepse ti je punëtor dhe e meriton votën.

Kryetari z.Rakip Suli,

Shumë faleminderit për vlerësimin e të gjithë punëve që kemi bërë. Patjetër që ka akoma punë për të bërë, por bashkërisht do t'i realizojmë. Dhe ju bëj thirrje të gjithëve që për çdo pakënaqësi të trokisni në derën e Bashkisë. Ju faleminderit të gjithëve.

Në fund të diskutimit, kryebashkiaku Suli, falënderoi të pranishmit duke thënë se kërkesat, sugjerimet dhe idetë e tyre do të diskutohen dhe do të merren parasysh për t'u implementuar në projektet që përbëjnë buxhetin e Bashkisë Kamëz.





